



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1263/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lulbardha Berisha kandidate për anëtar të kuvendit komunal nga radha e PDK-së në Dragash, paraqitur kundër Komisioni Qendror Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lulbardha Berisha, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Dragash, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

### Arsyetim

Me datën 03.12.2013 në ora 16:25, Lulbardha Berisha kandidate për anëtarë të kuvendit komunal nga radha e PDK-së në Dragash ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se sipas rezultateve të publikuar nga KQZ të datës 5 Tetor posedon 89 vota që dot thotë e treta në listën e kandidateve të PDK-së për asamblist, por me publikimin e rezultateve të KQZ-së të datës 02 Nëntor tani radhitet e katërta në listë, thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidates për asamble komunale Lulebardha Berisha nga radha e PDK-së, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi apo provë, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1263/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.